



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI

Nr. 1456/Prot.

Vau Dejës, me 03.04.2025

VENDIM
Nr. 9, Datë 03/04/2025

**“PËR CAKTIMIN E VENDEVE TË AFISHIMIT TË MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE PËR ZGJEDHJET VENDORE TË DATËS 11 MAJ 2025”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “ *Për vetëqeverisjen Vendore*”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008” *Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar; si dhe Udhëzimit nr.6, datë 23.03.2021, të Komisionit Shtetëror të zgjedhjeve , “ *Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore*”.

VËNDOSA:

- 1) Vendet e afishimit të materialeve propagandistike zgjedhorë të caktohen hapësirat deri në 5(pesë) metra nga zyrat zgjedhore e partisë politike përkatëse, pasi të kenë bërë njoftimin me shkrim Kryetarit të Bashkisë, për hapjen e zyrave zgjedhore dhe për adresat e tyre të sakta. Materialet propagandistike zgjedhore lejohet të afishohen deri në një distancë prej 5(pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhore përkatëse jo më parë se 30(tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve. Me mbarimin e fushates zgjedhore, subjektet zgjedhore marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.
- 2) Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në : fasadat e godinave të banimit, institucionet publike apo ambienteve rrethuese pranë tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit apo shtyllat e ndriçimit dhe në mjetet e transportit publik.
- 3) Në vendet e afishimit subjektet zgjedhore lejohet të afishojnë vetëm materiale të programeve të tyre zgjedhore.
- 4) Partitë Politike duhet ti përmbahen rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe Udhëzimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- 5) Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit të monitorojnë procesin e afishimit si dhe të marrë masa për të mos lejuar apo të heqin mënjeherë çdo material statike, përfshirë posterat dhe flamujt nga çdo vendnodhje tjetër ku ato konstatohen që nuk janë vendosur



në përputhje me Kriteret e Udhëzimit nr.6, datë 23.03.2021”Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Kristian Shkreli

